



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA TË QEVERISË FRANCEZE
PËR STUDIME MASTER**

THIRRJE PËR KANDIDATURA PËR VITIN UNIVERSITAR 2024-2025

Dëshironi të vazhdoni studimet në Francë në vitin universitar 2024-2025 ? Ambasada e Francës në Shqipëri ofron bursa të Qeverisë Franceze për kandidatët e motivuar, me rezultate të larta dhe me një projekt solid. Bursat janë për nivelin Master.

Fushat e synuara janë:

- Inovacion/shkenca informacioni (web3, inteligjencë artificiale, etj.),
- Mjedis/Menaxhim territori (zhvillim i qëndrueshëm, strategji, planifikim)
- Turizëm (menaxhim, hoteleri, agro-turizëm)

Master 2 do të ketë përparësi ndaj Master 1.

Bursa e masterit përfshin:

- pagesë mujore prej 860 € e cila nuk mund të kalojë 10 muaj;
- përjashtimin nga tarifa e regjistrimit në institucionet publike që varen nga ministria e ngarkuar me arsimin e lartë;
- tarifë falas për vizën;
- sigurim social;
- ndihmë në gjetjen e strehimit.

Bursa nuk mbulon biletat e avionit.

Kushtet dhe kriteret për t'u përzgjedhur

Mund të përfitojë bursë të Qeverisë Franceze kandidati që plotëson kriteret e mëposhtme:

- të jetë me kombësi shqiptare
- të jetë rregullisht i regjistruar ose i diplomuar në një institucion shqiptar të arsimit të lartë ose të ketë një diplomë shqiptare
- të jetë nën 30 vjeç në 31 dhjetor 2024
- të ketë një projekt studimi në një nga fushat e synuara të sipërpërmendura
- të ketë aplikuar në një ose më shumë universitete franceze të zgjedhura sipas dëshirës.
- të ketë njohuri të gjuhës frënge në përshtatje me kërkesat e universitetit ose të fushës.

Kujdes : Bursa nuk mund t'u jepet kandidatëve shqiptarë që janë tashmë studentë në Francë.

Dosja e kandidaturës

Dosja e kandidaturës duhet detyrimisht të përmbajë dokumentet e mëposhtme :

- Formularin e kandidaturës;
- Kopjen e pasaportës ;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

- Kopjen e diplomës së *Bachelor*-it dhe listat e notave të *Bachelor* dhe Master 1 per regjistrimet ne Master 2 (dokumente të përkthyer dhe të noterizuara) ;
- Diplomën e gjuhës frënge (B2) ose angleze sipas masterit të parashikuar ;
- C-V në frëngjisht (në anglisht vetëm për shkollimin në anglisht) ;
- Letrën e motivimit në frëngjisht për të prezantuar projektin e shkollimit në Francë (në anglisht vetëm për shkollimet në anglisht) ;
- Letra/t e rekomandimit nga drejtuesi dhe/ose një pedagog i universiteit nga vjen kandidati ;
- Vërtetimin e regjistrimit ose kopje të korespondencës së shkëmbyer me universitetin francez. Bursat u jepen vetëm kandidatëve që kanë një regjistrim në një universitet francez.

Kalendari i përgjithshëm

5 prill 2024: data e publikimit të thirrjes për aplikime;

17 maj 2024: afati i fundit për dorëzimin e dosjeve të aplikimit (që duhet të dërgohen në adresën e treguar më poshtë);

20 maj - 17 qershor 2024: shqyrtimi i dosjeve dhe publikimi i listës së kandidatëve të parapërzgjedhur;

18, 19, 20 qershor: intervistimi i kandidatëve të parazgjedhur me jurinë.

Fund qershori : publikimi i rezultateve. Do të krijohet një listë plotësuese në rast tërheqjeje të ndonjë prej kandidatëve të përzgjedhur.

Fillim korriku: Kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen nga Ambasada Franceze për të përgatitur dosjet e tyre administrative, pas pranimit përfundimtar të tyre nga institucioni francez.

Zhvillimi i procedurës

Aplikimet duhet të dërgohen me e-mail në scac.tirana-amba@diplomatie.gouv.fr përpara të premtes 17 maj 2024. Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen vetëm në mënyrë elektronike, detyrimisht në format PDF (madhësia e të cilit nuk duhet të kalojë 7 MB). Asnjë aplikim nuk do të pranohet pas kësaj date dhe çdo aplikim i paplotë ose që nuk përmbush kriteret do të refuzohet. Regjistrimi i aplikimeve do të konfirmohet me e-mail brenda 72 orëve nga marrja e aplikimit, me e-mail.

Aplikimet do të shqyrtohen nga Zyra e Bashkëpunimit dhe Veprimit Kulturor e Ambasadës së Francës në Shqipëri. Juria është sovraane dhe vendimi i saj është përfundimtar.

Për më shumë informacion vizitoni faqen:

<https://al.ambafrance.org/Bourses-du-gouvernement-francais-pour-des-etudes-de-Master-Appel-a-candidatures-3203>